



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:208486

Datë: 14.12.2022

Numri i dokumentit: 03754362

P.nr.1016/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpuntoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. V. nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nën par.3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. F. K. nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani, me numër PP.II.nr.../2022 të datës 31.10.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik të dt.08.11.2022, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 08.12.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A. V. nga babai E. dhe nëna V., e gjinisë M., i lindur me datë..... në Gjilani, ku edhe jeton, në rr.” Sh. Gj.”, nr...../..., i martuar, babë i ... fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në autoshkollën “E.T.”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 10.10.2022, rreth orës 19:00, në rr.”Sh. Gj.” në Gjilani, në shtëpinë familjare, i pandehuri A. V., me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor ka ushtruar dhunë në familje duke e lënduar lehtë të dëmtuarën –bashkëshorten e tij L. V., në atë mënyrë që nën ndikimin e alkoolit me 0.89%, fillon të fjaloset me të dëmtuarën dhe pas një mosmarrëveshje rreth konsumit të cigares brenda pasi e dëmtuara hap dritaren që të ajroset dhoma i pandehuri revoltohet dhe fillon ti bërtasë duke i thënë nuk kam harruar se çka më ke bërë në Izrael, pastaj e kap me duar për fyti dhe ia mbyll gojën dhe hundën që mos të lëshojë zë pasi e dëmtuara fillon të qajë, dhe i thotë se “këtu është Kosovë dhe askush nuk do të ndihmojë”, dhe e godet me shuplaka fytyrës disa here, me pas e kap për flokë dhe e përplas për krevati, me çrast e dëmtuara me vajzën e vogël në krah ikën përmes garazhës ku përsëri i pandehuri tenton ta pengojë duke ia mbajtur derën por ajo arrin të dalë në rrugë e zbathur, ku kërkon ndihmë dhe disa kalimtarë e njoftojnë policinë, e që si pasojë e dhunës fizike të dëmtuares i shkakton lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjes në kokë dhe trup, si dhe mavijosje në krahun e

majtë të evidentuara në raportin mjekësor nr.23755 i dt.10.10.2022, që sipas ekspertizës mjekoligjore konstatohen si dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3, nën para.3.1 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,42,48,49,50,51,52,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të akuzuarin A. V. e :

E GJYKON

Me dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dënim i cili do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit A. V., dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, **ZËVENDSOHET** me dënim me gjobë në shumë prej 1200.00€ (njëmijë e dyqind -euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk është në gjendje të paguaj dënimin me gjobë, atëher dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim , në atë mënyr që për çdo 20 € (njëzet) do to caktohet një dit burgim.

Në bazë të nenit 79 paragrafi 1 të KPRK-së, koha e kaluar në paraburgim nga data **10.10.2022** e deri më **09.11.2022**, **do ti llogaritet në dënimin e zëvendësuar me gjobë.**

E dëmtuara L. V. nga Gjilani, rr. “Sh. Gj.”, nr./....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë-euro), si dhe shumë prej 30 € (tridhjetë-euro), për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 31.10.2022, ka dorëzuar aktakuzën në gjykatë, me numër PP.II.nr.../2022 e datës 31.10.2022, kundër të akuzuarit A. V. nga Gjilani, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nën para.3.1 të KPRK-ës.

Me datë 08.11.2022 gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri, si dhe i akuzuari A. V., me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av.F. K. nga Gjilani, në të cilën seancë, i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe është penduar për këtë që ka ndodhur, i vije keq që i ka shkaktuar lëndime të dëmtuarës

dhe kërkon falje për të njëjtën e cila nuk ishte prezente në seancë ngase e njëjta është kthyer te vendlindja e saj në Izrael, i premtun gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris këtë veprë apo veprë tjetër penale duke kërkuar që ti shqiptohet një dënim më i butë.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: deklarata e të pandehurit A. V., deklaratat e të dëmtuarës L. V., deklarata e dëshmitares V. V., raporti mjekësor nr....., i dt.10.10.2022, i lëshuar nga spitali Regjional i Gjilani/Emërgjenca, ekspertizat mjekoligjore, fotografit mbi natyrën e dëmtimit trupor tek e dëmtuara, dëshmi për matjen e alkoolit, raporti i QPS në Gjilan me nr...-..... i dt.12.10.2022, forma bazike e viktimës së dhunës në familje, raporti i oficerit, e kaluara kriminale, parashtresa e ZMNV, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtarja e vetme gjykuese vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri i lartëcekur, e ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3, nën par.3.1. të KPRK-ës.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej **1200 € (njëmijë e dyqind-euro)**, të cilën gjobë i pandehuri obligohet ta paguajë në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita kur ky aktgjykim të marrë formën e prerë, ngase duke i marrë parasysht të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71, dhe 72 të KPRK-së ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilën i vihen në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale përkatësisht i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij duke i kërkuar falje tani të dëmtuarës, se i njëjti i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori dashjen e tij, për ta kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ngase nga shkresat e lëndës del se i njëjti e kishte kryer veprën penale e cila i vihet ne barre.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Të dëmtuaren L. V. nga Gjilani, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, e udhëzoi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil.

Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit A. V., duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjykata po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Llogaritje e paraburgimit – në dënimin e shqiptuar

Në 79 paragrafi 1 të KPRK-ës parashihet se “*Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë*”, ku i pandehurit të lartcekur, prej datës 10.10.2022 e deri më 09.11.2022, koha e kaluar në paraburgim, do të llogaritet në dënimin e zëvendësuar me gjobë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka obliguar që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 25 (njëzet e pesë-euro) €, si dhe shumën prej 30€ (tridhjetë-euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Më dt.08.12.2022

P.nr.1016/2022

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.